

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti Për Çështje Ekonomike**, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit “A.G” Sh.p.k. me NRB ..., me seli në P, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.T avokat nga P, kundër të paditurës N.P.T. “A.P”, me NRB ..., me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.O avokat nga P, me objekt kontesti shkeljen e markës tregtare, në vlerë të përgjithshme prej 25,000.00 euro, pas përfundimit të seancës kryesore publike të datës 22.02.2018, në prani të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarit të paditurës, pas marrjes së fjalëve përfundimtare nga palët në procedurë, ndërsa me datë 12.03.2018 merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “A.G” Sh.p.k. me NRB , me seli në P, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura N.P.T. “A.P”, me NRB .., me seli në P, ka shkelur markën tregtare të paditësit, të detyrohet e paditura për ndalimin e shkeljes dhe ndalimin e vazhdimit të shkeljeve të tilla dhe të ngjajshme në të ardhmen, ndërprerjen e mëtutjeshme të shkeljes së të drejtave të fituara në bazë të nenit 8 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit për markat tregtare, që kanë shkelur apo përbëjnë tentim serioz për shkeljen e mundshme të markës së tij tregtare, produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e të paditurit si dhe të detyrohet e paditura që në gazetën ditore të publikojë aktykimin duke bartur shpenzimet e publikimit, po ashtu ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të kompensimit të dëmit të paguajë shumën prej 25,000.00 euro, si dhe ti paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II. DETYROHET** paditësi që palës së paditur t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,185.60 euro, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi

### **A r s y e t i m**

Paditësi “A.G” Sh.p.k., me seli në P, ka parashtruar pranë kësaj gjykate padi me datë 05.05.2017, kundër të paditurës “A.P”, me seli në P, duke i propozuar kësaj gjykate që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit me të cilën do të vërtetohet se e paditura N.P.T. “A.P”, me seli në P, ka shkelur markën tregtare të paditësit, të detyrohet e paditura për ndalimin e shkeljes dhe ndalimin e vazhdimit të shkeljeve të tilla dhe të ngjajshme në të ardhmen, ndërprerjen e mëtutjeshme të shkeljes së të drejtave të fituara në bazë të nenit 8 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit për markat tregtare, që kanë shkelur apo përbëjnë tentim serioz për shkeljen e mundshme të markës së tij tregtare, produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e të paditurit si dhe të detyrohet e paditura që në gazetën ditore të publikojë aktykimin duke bartur shpenzimet e publikimit, po ashtu ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të kompensimit të dëmit të paguajë shumën prej 25,000.00 euro, si dhe ti paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit të çështjes gjyqësore ka mbetur pranë padisë dhe kërkesës së tij, duke shtuar se paditësi është pronar i markës tregtare të regjistruar pranë zyres për pronësi industriale në Kosovë dhe marka tregtare “H” është e mbrojtur në regjistrin e markave tregtare me vendimet me nr.20437, nr.20435, nr.20440, nr.20434, nr.20436, nr.20443 vendime të datës 28.03.2017. Produkti “H” është regjistruar sipas klasifikimit ndërkombëtar të Nice-s, letra për përdorim shtëpiak dhe higjienë. Duke shtuar se e paditura ka shkelur markën e mbrojtur të paditësit me produktet e tij “A” pasi që të njëjtat janë pothuajse identike me paketimin e produktit të paditësit, andaj dhe kjo paraqet shkelje të markës tregtare dhe për shkak të ngjajshmërisë ose identitetit vizuel, motivet në ngjyra si dhe ngjajshmëria sematike apo konceptuale në mes produktit të paditësit dhe të paditurit ashtu që ekziston mundësia e konfuzionit të konsumatorit ku përfshihet edhe mundësia e asocimit me markën e mbrojtur, andaj edhe i ka kërkuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurës përmes përgjigjes në padi dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se e paditura nuk ka bërë kopjimin apo shkeljen e markës tregtare të paditësit, pasi që ai është pronar i markës tregtare të vetë origjinale dhe e njëta nuk e shkel markën tregtare të paditësit, po ashtu ka theksuar se paketimi i produktit të paditësit dallon nga paketimi i produktit të paditurës ngase elementet dalluese të markës tregtare të paditësit shihet në ngjyra, në fond tjetër të shkonjave dhe elemente tjera dalluese të cilat i kanë produktet e të paditurës kurse produktet e paditësit nuk i kanë andaj edhe nuk ekziston mundësia që konsumatorët të vëhen në konfuzion apo ngjajshmëri lidhur me produktin e të paditurës, andaj dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata ka administruar këto prova duke lexuar: Certifikata për markën tregtare me nr... i datës 23.08.2017, vendimi me nr.20437 i datës 28.03.2017, certifikata për markën tregtare e nr.20435 e datës 23.08.2017, vendimi me nr. 20435 i datës 28.03.2017, certifikata për markë tregtare me nr.20440 e datës 28.03.2017, vendimi me nr.20440 i datës 28.03.2017 certifikata për markë tregtare me nr.20434 e datës 28.03.2017, vendimi me nr.20434 i datës 28.03.2017, certifikata për markë tregtare me nr.20436 e datës 23.08.2017, vendimi me nr.20436 i datës 23.08.2017, certifikata për markë tregtare me nr.20443 e datës 28.03.2017, vendimi me nr.20443, 28.03.2017 si dhe mostrat e paditësit, shkresë elektronike e datës 14.04.2017, 12.04.2017, 17.04.2017, mostrat e të paditurës certifikata e biznesit të paditësit me nr.70442957, Certifikata e biznesit e të paditurës me nr...

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të LPK-së, dhe gjeti se:

Nga vendimet me nr.20437 është e mbrojtur ngjyra e bardhë, e kaltër, e verdhë dhe ngjyra ari, për produktin me vendimin nr.20435 është e mbrojtur ngjyra e bardhë, e gjelbërt, e verdhë dhe ngjyra ari, për produktin me vendimin nr.20440 është e mbrojtur ngjyra e bardhë, e kuqe, e kaltër dhe e gjelbërt, për produktin me vendimin nr.20434 është e mbrojtur ngjyra e bardhë, e kuqe dhe e gjelbërt, për produktin me vendimin nr.20436 dhe vendimin nr. 20443 janë të mbrojtura ngjyra e bardhë, e kaltër, e gjelbërt dhe ngjyra vjollce, ashtu që nga këto vendime gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka të mbrojtur markën tregtare me emërim “H”, e cila nuk ka qenë kontestuese as në mes palëve në procedurë.

Nga shkresa e datës 12.04.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka njoftuar të paditurën lidhur me kërkesën për ndërprerjen e shkeljës së markës tregtare, nuk ka qenë kontestuese në mes palëve në procedurë.

Nga përgjigjja e datës 17.04.2017, e të paditurës e bërë në shkresën e paditësit të datës 12.04.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura e ka bërë ridizajnimin e të gjitha produkteve të saj dhe se në treg mund të ketë vetëm produktet të cilat e paditura i ka në stok.

Kështu gjykata pas administrimit të provave të cekura pas vlerësimit dhe analizimit të gjitha pretendimeve të palëve në procedurë të cekura në procesverbal edhe parashtresa gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar për këto arsye:

Nga vështrimi me kujdes i paketimeve të kontestuara gjykata ka gjetur se këto paketime janë të dallueshme dhe nuk përngjajnë njëra me tjetrën edhe pse kanë përafërsisht ngjyrë të njëjtë. Janë shenja të tjera që dallohen esencialisht siç janë: emri personal i markës, skicimi i markës, shkronjat e paketimit si dhe figurat tjera e që në mënyrë të qartë e bëjnë dallimin mes tyre.

Paketimi i paditësit i mbrojtur me vendimin nr.20435 të datës 28.03.2017 ka shkronja të tjera identifikuese siç janë: “H”, e që këtë emërtim nuk e ka paketimi i të paditurit “A”. Pastaj emërtimi nën emrin “H” është fjala “Ch” e përcjellur me fjalinë “W.T” dhe “P.Q” në gjuhën angleze, e që është fjala e parë është me shkronja bollid ngjyrë të kuqe kurse fjalët tjera me shkronja të shtypura të një stili tjetër të vendosura në pjesën mbështjellëse të paketimit me ngjyrë të zezë, veçori këto të cilat nuk i ka produkti i të paditurës pasi që e njëjta ka emërim në kapak (pjesën mbyllëse) “A” me ngjyrë të verdhë, në pjesën e sipërme ka mbishkrimin “H& Ch” kurse në pjesën e poshtme ka mbishkrimet “W.T” dhe “P.Q” në gjuhën angleze duke shtuar fjalinë “H& Ch” dhe pashtaj mbishkrimin “A” me një dizajn dhe ngjyrë të kaltër. Pastaj paketimi i paditësit në anën e djathtë të paketimit e ka një enë apo kavanoz me mjaltë me dy lule të kamomilit me një shkop druri, ashtu që produkti i të paditurës “A” po ashtu ka një enë apo kavanoz me mjaltë dhe me shkop druri mirëpo dallojnë për nga forma dhe madhësia e tyre po ashtu në anën e majtë të enës apo kavanozit gjendet një hojë i bletëve me një lule kamomili të cilën nuk e ka paketimi i paditësit “H”, po ashtu paketimi i paditësit në anën e majtë ka dy lule të kamomilit dhe tri lule në pjesën e poshtme të tij kurse në mes të këtyre shkruan “A& P.F”, kurse paketimi i të paditurës në anën e majtë ka tri lule të kamomilit kurse në pjesën e poshtme ka vetëm një lule të kamomilit kurse në mes ka shkrimin “100 PCS”, që do të thotë që dallon produkti i paditësit.

Paketimi i paditësit i mbrojtur me vendimin nr.20440 i datës 28.03.2017, ka shkronja të tjera identifikuese siç janë: “H” i cili mbishkrim gjendet në kapakun (pjesën mbyllëse), e paketimit, e që këtë emërtim nuk e ka paketimi i të paditurit “A”. Pastaj emërtimi nën emrin “H” është fjala “B-C” me shkronja bolld ngjyrë të kuqe, kurse produkti i të paditurës ka në kapak (pjesën mbyllëse) emërtimin “A” me ngjyrë të portokallt, në pjesën e sipërme ka shkrimin “C” kurse në pjesën e poshtme fjalën “B”, që dallon nga produkti i paditësit. Pastaj paketimi i paditësit në anën e majtë ka dy fruta të brusnicës kurse paketimi i të paditurës ka disa sosh, po ashtu në pjesën e poshtme në mes të paketimin nën fjalën Cranberry është emërtimi “A” në anën e djathtë me një frut të brusnicës ngjyrë të kuqe të vendosur në një gjethe në ngjyrë të gjelbërt, veçori këto të cilat e bëjnë të dallueshme dhe që nuk kanë ngjajshmëri produkti i të paditurës me produktin e paditësit.

Po ashtu paketimi i paditësit i mbrojtur me vendimin nr.20436 të datës 28.03.2017 ka shkronja të tjera identifikuese siç janë: “H”, e që këtë emërtim nuk e ka paketimi i të paditurit “A”. Pastaj emërtimi në pjesën e sipërme të fjalës “H” është fjala “L” e përcjellur me fjalinë “W.T” dhe “P.Q” në gjuhen angleze, veçori këto të cilat nuk i ka produkti i të paditurës pasi që e njëjta ka emërim në kapak (pjesën mbyllëse) “A” me ngjyrë vjollce, në pjesën e poshtme ka mbishkrimin “L” me një fond dhe stil tjetër të shkronjave dhe në pjesën e poshtme ka emërin “A” me ngjyrë të kaltër. Pastaj paketimi i paditësit në anën e djathtë të paketimin i ka një vizatim si një vijë të trashë ngjyrë vjollce, ashtu që produkti i të paditurës “A” në anën e djathtë ka një tufë lule ngjyrë vjollce të cilat nuk i ka produkti i paditësit, po ashtu paketimi i paditësit në anën e majtë ka një lule ngjyrë vjollce, kurse paketimi i të paditurës në anën e majtë ka një tufë lule ngjyrë vjollce, e që këto karakteristika e bëjnë edhe këtë produkt të paditurëstë dallon nga produkti i paditësit.

Sipas nenit 5 të Ligjit për markat Tregtare, kusht për regjistrimin e markës tregtare është mundësia e paraqitjes grafike të markës, ndërsa me vendimin e MTI-së, marka tregtare e paditësit “H” është regjistruar si kombinim i ngjyrave të mbrojtura në dizajnin e caktuar dhe se kjo markë tregtare gëzon mbrojtje vetëm me këtë dizajn të dhënë në vendimet (nr.20437, nr.20435, nr.20440, nr.20434, nr.20436, nr.20443 lëshuar nga MTI), sepse do të ishte jashtë çdo logjike që paditësi me vetë faktin e regjistrimit dhe mbrojtjes së ngjyrave të caktuara ti’a mohojë çdo prodhuesi përdorimin e këtyre ngjyrave në çfarëdo forme dhe në çfarëdo kombinimi. Prandaj gjykata ka vlerësuar se përdorimi i ngjyrave për afërsisht të njëjta me nuanca dalluese në produktin e të paditurës, në dizajn, formë tjetër dhe me kombinime tjera nuk e shkelin markën tregtare të paditësit.

Gjykata ka gjetur se ekzistojnë dallime të dukshme edhe në elementin “aural” sepse shenja “H” dhe “A” kanë dallime të theksuara në shprehjen e tyre, mandje ato janë plotësisht të ndryshme, andaj edhe në këtë element produkti i të paditurës nuk mund të shkaktojë konfuzion te konsumatori.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe formën e paketimit të produkteve përkatësisht formën katrore-drejtëkëndëshit të ambalazhit e cila është e njëjt tek produktet e palëve në procedurë dhe se në këtë rast forma përbën “një formë funksionale” të vetë produktit siç parashihet edhe në nenin 6 pika 1.5 të Ligjit për Markat Tregtare i cili e ndalon mbrojtjen e shenjave të cilat

përbejnë një trajtë që “1) rezulton nga natyra e vetë mallit përkatës, 2) është e nevojshme për të arritur një rezultat teknik ose 3) i jep vlerë thelbësore mallit në fjalë”, andaj sipas kësaj dispozite një formë që është funksionale nuk mund të gëzojë mbrojtje. Nocioni i funksionalitetit është mekanizëm për parandalimin e monopolit mbi një formë të caktuar të mallit e cila është e nevojshme për arritjen e një rezultati të caktuar. Forma e paketimit të produkteve kontestuese përdoret tek të gjitha produktet e kësaj natyre, prandaj përdorimi i kësaj forme nuk mund të ndalohej, përkatësisht përdorimi i kësaj forme nuk përbën shkelje të markës tregtare.

Po ashtu edhe në paketimet tjera të paditurës të sqaruara më lartë në të cilat ekzistojnë dallime esenciale të produkteve të cilat në mënyrë shumë të qartë dallojnë në mes veti, karakteristika këto që i bëjnë të dallueshme produktet në mes veti, andaj të gjitha këto e bëjnë që të mos të përmbushen kushtet e parapara në nenin 6 dhe 7 të Ligjit mbi Markën Tregtare, sepse nuk ekziston mundësi e mashtrimit të konsumatorit sa i përket shenjave dalluese të këtyre paketimeve, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të autorizuarit të palës paditëse lidhur me atë që të detyrohet e paditura të paguajë shumën prej 25,000.00 euro, për denigrim të reputacionit të markës së mbrojtur të paditësit, mirëpo këtë pretendim gjykata e refuzoj si të pa bazuar për arsye se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar si dhe gjykata ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike sipas arsyetimit të lartë cekur ashtu që marka tregtare e paditësit nuk është shkelur nga e paditura andaj edhe kërkesa e paditësit për dëmtim të reputacionit nuk qëndron pasi që markat tregtare dallojnë në mënyrë esenciale mes veti, prandaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me aktvendim ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të palës së paditur lidhur me caktimin e ekspertizës financiare për arsye se kërkesëpadiisë së paditësit i mungon baza juridike e kërkesëpadiisë, andaj edhe gjykata e refuzoj një propozim të tillë për hire të mos zvarritjes së procedurës dhe ekonomizimit të saj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe paragrafin 5 lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri dhe atë: për përgjigjen në padi shumën prej 104.00 euro, si dhe në emër të përfaqësimit në katër seanca gjyqësore (4x270.40 euro) shumën prej 1,081.60 euro, gjithsej shumën prej 1,185.60 euro.

Andaj nga të cekurat si më lart dhe duke u bazuar në nenin 5, 6, 7 të Ligjit për Markat Tregtare si dhe në nenin 143 të LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti Për Çështje Ekonomike**  
**III.EK.nr.230/17 me datë 12.03.2018**

**Gjyqtarja**  
Franciska Zhitia-Ymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.